



Komuna e Fushë Kosovës/Opstina Kosovo Polje
Municipality of Fushë-Kosovë/Kosovo Polje



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, mbështetur në nenin 35 të Rregullores me nr. 145 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale dhe kufizimet bugetore në programin e kulturës, rinisë dhe sportit, merr këtë:

VENDIM Nr. 80/25

Për anulimin e Thirrjes së fazës së III Publike për mbështetje financiare të klubeve/organizatave sportive dhe kulturore për vitin 2025.

Arsyetim

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Fushë Kosovës, më datë 15.07.2025 ka shpallur Thirrjen Publike me nr. prot.1306 për mbështetje financiare të klubeve sportive dhe organizatave kulturore.

Pas shpalljes së thirrjes, është formuar Komisioni Vlerësues, mirëpo për arsye të mosfunksionalitetit/anulimit të mbledhjeve të komisionit, procesi i vlerësimit të aplikimeve nuk ka mundur të zhvillohet sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara.

Po ashtu gjatë rishikimit të gjendjes financiare për vitin 2025, është konstatuar një mungesë e mjeteve të mjaftueshme financiare, si pasojë e prioriteteve të reja dhe rritjes së shpenzimeve në sektorë të tjerë esencialë dhe marrjes së mjeteve financiare nga përmbaruesi privat për shumë lëndë në arsim.

Duke u bazuar në nenin 90 dhe 91 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në mungesë të mundësisë për realizimin e procedurës së rregullt të vlerësimit, Drejtoria vendos:

Anulohet Thirrja Publike me nr. prot. 1306 e datës 15.07.2025 për mbështetje financiare të klubeve/organizatave sportive dhe kulturore për vitin 2025. Palët e interesuara do të njoftohen me kohë për shpalljen e një thirrjeje të re publike, pas krijimit të kushteve të nevojshme procedurale.

Vendimi për anulimin e thirrjes së tretë është një masë e përkohshme dhe e arsyetuar që ka për qëllim ruajtjen e seriozitetit të procesit të mbështetjes publike.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Drejtori:

Ali Topalli

